


## Pasqyrat Financiare

<b>BILANCI I GJENDJES</b>		<b>31 dhjetor 2004</b>	<b>31 dhjetor 2003 (rishikuar) ( EUR 000)</b>
<b>ASETET</b>	<b>Shënim</b>	<b>( EUR 000)</b>	<b>( EUR 000)</b>
<b>Asetet fikse</b>			
Prona, ndërtesat dhe pajisjet	<b>3</b>	57,272	66,295
Asetet e patrupëzuara	<b>4</b>	15,356	8,042
		<u>72,628</u>	<u>74,337</u>
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Inventari	<b>5</b>	2,906	2,087
Llogaritë e arkëtueshme	<b>6</b>	20,052	32,587
Të arkëtueshme të tjera	<b>7</b>	4,519	2,360
Paraja dhe bilancet e bankës	<b>8</b>	157,410	96,408
		<u>184,887</u>	<u>133,442</u>
<b>Totali i asetëve</b>		<b>257,515</b>	<b>207,779</b>

### KAPITALI DHE DETYRIMET

<b>Kapitali dhe kursimet</b>			
Llogaritë e kapitalit	<b>9</b>	36,842	36,842
Fitimet e mbajtura	<b>10</b>	207,095	159,317
		<u>243,937</u>	<u>196,159</u>
<b>Detyrimet kurente</b>			
Llogaritë e pagueshme	<b>11</b>	3,762	3,469
Llogaritë tjera të pagueshme	<b>12</b>	7,752	7,697
Të hyrat e shtyra	<b>13</b>	2,064	454
		<u>13,578</u>	<u>11,620</u>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>257,515</b>	<b>207,779</b>

Autorizuar për t'u lëshuar nga Bordi i Drejtorëve të Përkohshëm të PTK-së



Z. Gavin Jeffery  
Drejtor Menaxhues



Z. Cyril Rumble  
Shef i Financave

PASQYRAT E OPERIMEVE	Shënim	Fund viti	Fund viti
		31 dhjetor 2004	31 dhjetor 2003
		( EUR 000)	( rishikuar) ( EUR 000)
Të hyrat operative	14	128,483	118,802
Shpenzimet operative	15	(18,035)	(20,561)
Shpenzimet e personelit	16	(19,044)	(16,114)
Zhvlerësimi	3	(15,998)	(15,828)
Amortizimi	4	(2,202)	(958)
Shpenzime të tjera operative	17	(14,168)	(14,594)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>59,036</b>	<b>50,747</b>
Të hyrat financiare	18	3,854	1,138
Te hyrat tjera jo operative		229	205
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>63,119</b>	<b>52,090</b>
Tatimi në fitim	19	(15,341)	(12,803)
<b>Fitimi pas tatimit</b>		<b>47,778</b>	<b>39,287</b>

Barazimi i fitimit të vitit paraprak siç është raportuar më parë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003 (EUR 000)
Fitimi pas tatimit i rishikuar	39,287
Përshtatjet me vitin paraprak (Shënimi 10)	(9,837)
Fitimi pas tatimit siç është raportuar më parë	29,450

Deklarimet e Ndryshimeve në Kapital dhe Rezerva	Llogaria e Kapitalit ( EUR 000)	Fitimiet e mbajtura ( EUR 000)	Totali ( EUR 000)
<b>Bilanci më 1 Janar 2003 siç është raportuar më parë</b>	<b>36,842</b>	<b>121,505</b>	<b>158,347</b>
Përshtatjet me vitin paraprak (Shënim 10)	-	(1,475)	(1,475)
<b>Bilanci më 1 janar 2003 e rishikuar</b>	<b>36,842</b>	<b>120,030</b>	<b>156,872</b>
Fitimi për 2003	-	29,450	29,450
Përshtatjet me vitin paraprak (Shënim 10)	-	9,837	9,837
Fitimi pas tatimit për 2003 siç është rishikuar	-	39,287	39,287
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2003 e rishikuar</b>	<b>36,842</b>	<b>159,317</b>	<b>196,159</b>
Fitimi për 2004	-	47,778	47,778
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>36,842</b>	<b>207,095</b>	<b>243,937</b>

	Fund viti 31 dhjetor 2004  ( EUR 000)	Fund viti 31 dhjetor 2003 (i rishikuar) ( EUR 000)
<b>BILANCI I RRJEDHJES SË PARASË</b>		
<b>RRJEDHJET E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE</b>		
Të ardhurat operative	128,483	118,802
Të hyrat financiare	3,854	1,138
Të ardhurat tjera jo operative	229	205
Shpenzimet operative	(18,035)	(20,561)
Shpenzimet e personelit	(19,044)	(16,114)
Shpenzime të tjera operative	(14,166)	(14,594)
<b>Paratë e gjeneruara prej operimeve</b>	<b>81,321</b>	<b>68,876</b>
<b>Ndryshimet në asetet operative dhe detyrimet</b>		
Llogaritë e arkëtueshme	12,535	1,606
Të arkëtueshme të tjera	(2,159)	10,987
Inventari	(819)	(45)
Investimet afatshkurta	(22,192)	(23,300)
Llogaritë e pagueshme	293	(544)
Llogari të tjera të pagueshme	(125)	(5,541)
Të hyrat e shtyra	1,610	(183)
	<b>70,464</b>	<b>51,856</b>
Pagesat e realizuara për tatimin në fitim	(15,161)	(13,528)
<b>Paratë neto të nxjerra nga aktivitetet operative</b>	<b>55,303</b>	<b>38,328</b>
<b>RRJEDHJA E PARASË PREJ AKTIVITETET OPERATIVE</b>		
Blerja e pronave, ndërtesat dhe pajisjet	(6,977)	(6,751)
Blerja e aseteve të pa trupëzuara	(9,516)	(8,977)
<b>Paratë neto të shfrytëzuara në aktivitet investuese (16,493)</b>		<b>(15,728)</b>
<b>Rritja e netos në para dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>38,810</b>	<b>22,600</b>
<b>Paratë dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit</b>	<b>73,108</b>	<b>50,508</b>
<b>Paratë dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>111,918</b>	<b>73,108</b>

## Raporti i Auditorëve të Pavarur

Ne ishim të angazhuar për auditimin e bilancit të gjendjes shoqëruar të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) si me 31 Dhjetor 2004 dhe 2003 dhe pasqyrat e operimeve, ndryshimeve në kapital dhe rezerva, dhe rrjedhjen e parasë për vitet që përfunduan. Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e menaxhmentit të PTK-së.

### Shmangiet nga Standardet Ndërkombëtare Kontabël

■ Në përgatitjen e këtyre Pasqyrave Financiare menaxhmenti nuk iu është bindur Standardeve Ndërkombëtare Kontabël në aspektet si në vijim:

■ Nuk është ngritur asnjë provizion për pjesën rrjedhëse të vlerave të tanishme të pagesave që priten në të ardhmen për sistemimin e obligimeve pensionale të cilat rezultojnë nga shërbimet e punëtorëve në periudhat e kaluara dhe të tanishme të kërkuara nga SNK Nr. 19 në përfitimet e punëtorëve si në 31 dhjetor 2004 ose 31 dhjetor 2003.

■ Nuk është marrë në konsideratë regjistrimi i përfitimit në taksa në të ardhmen si në 31 dhjetor 2004 ose 2003 për efektin e diferencave të përkohshme kohore siç është kërkuar nga SNK Nr.12 për tatimin në të ardhura.

■ Siç është cekur në shënimin 6 të ardhurat e thirrjeve hyrëse për rrjetin e telefonisë VALA 900 llogariten në bazë të parave të gatshme të pranuar më mirë se në baza të përlllogaritjes siç kërkohej nga SNK Nr.1 në prezantimin e pasqyrave financiare.

### Kufizimet në sferën e Auditimit

#### ■ Kompletimi i të ardhurave

Ka lëshime të rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme për të siguruar se të gjitha impulset e nxjerra nga thirrjet e klientëve prej lidhjeve fikse janë të faturuara dhe të ardhurat e mbledhura llogariten me saktësi. Të dhënat e klientëve të siguruara nga departamentet e faturimit dhe arkëtimit janë të pakompletuara dhe nuk mund të shfrytëzohen për të testuar vlefshmërinë ose kompletimin e të arkëtueshmeve. Në mungesë të kontrolleve themelore mbi faturimin dhe mbledhjen nuk ka pasur procedurë alternative të cilën mund ta përdornim për të vërtetuar kompletimin e të ardhurave të linjës fikse ose të përcaktojmë shtrirjen e vjedhjeve dhe keqpërdorimeve në PTK për fund vitet 31 dhjetor 2004 dhe 2003.

Në PTK nuk ka kontroll mbi faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave të rrjetit të telefonisë mobile VALA 900. Telekom i Monakos ka faturuar dhe mbledhur të ardhurat për PTK-në. Nuk ka procedura alternative të kontrollit financiar të cilat mund të përdoren për auditimin e kompletimit të të ardhurave.

### ■ Mungesa e marrëveshjes ndërlidhëse me Telekom Serbia

PTK mundëson thirrjet fikse me administratat ndërkombëtare përmes Beogradit në lidhjet fikse të menaxhuara nga Telekom Serbia. Nuk ka kontratë formale në mes PTK-së dhe Telekom Serbia-së.

Prandaj, nuk ka marrëveshje ndërlidhëse e cila do të rregullonte lidhjen e ndërsjellë të trafikut telekomunikues. Derisa marrëveshja e tillë nuk ekziston efekti financiar i trafikut ndërlidhës nuk mund të matet me saktësi dhe rreziku i të ardhurave të pa evidentuara, shpenzimeve, asetëve dhe detyrimeve ekzistojnë si rezultat për të dy fund vitet, 31 dhjetor 2004 dhe 2003.

### ■ Nuk ka provision për detyrimet pensionale

Nuk ka vlerësim të saktë të pjesës rrjedhëse të vlerës së tanishme për pagesat që priten në të ardhmen që kërkohen për vendosjen e obligimeve pensionale që rezultojnë nga shërbimet e punëtorëve të aplikuar në periudhën e tashme dhe të kaluar. Në mungesë të një vlerësimi të tillë shtrirja e provizionit të kërkuar më 31 dhjetor 2004 dhe 2003 dhe kostoja e pensioneve për vit nuk kanë mundur të auditohen. Me 31 dhjetor 2004 fondi pensional përmbante investime prej 2.8 milion EURO ( 31 dhjetor 2003 1.4 milion EURO).

### ■ Opinioni i Auditimit

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të referuara në paragrafët e mësipërm shtrirja e punës sonë nuk ishte e mjaftueshme për të na mundësuar të shprehim, dhe ne nuk shprehim opinion për gjendjen e bilanceve të PTK-së si me 31 dhjetor 2004 dhe 2003 ose rezultatet e operimit të saj, ndryshimet në kapital dhe rezerva dhe rrjedhjen e parasë për fund vite.

### Theksimi i çështjes

Ne vëmë vëmendjen në Shënimin 3 të pasqyrave financiare në lidhje me mungesën e titullit të qartë të asetëve të infrastrukturës të trashëguara në fillimin e administrimit të KB në Kosovë.

Deloitte & Touche

Prishtinë,

Kosovë

31 mars 2005



## **1. PARATHËNIE**

Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është i autorizuar nga Kombet e Bashkuara në bazë të rezolutës Nr.1244 të Kombeve të Bashkuara për të administruar pasurinë e lëvizshme dhe të palëvizshme në territorin e Kosovës.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/12 qartëson se e drejta për të operuar me shërbimet postare dhe të telekomunikimit në Kosovë i është dhënë PTK-së. Aktualisht PTK është i vetmi furnizues i licencuar nën ligjet e telekomunikacionit të Kosovës. PTK ka filluar furnizimin me shërbimet e telekomunikimit mobil përmes operatorit të vet njësia Vala 900 në vitin 2000.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është formuar në korrik të vitit 2002 për të vepruar si administrues i besuar për pronarët dhe kreditorët e të gjitha ndërmarrjeve publike dhe të aseteve të tyre në Kosovë me një mandat për të rritur vlerën dhe realizueshmërinë e ndërmarrjeve.

Procesi i korporatizimit të PTK-së si një apo më shumë shoqëri në bashkëpronësi (aksionare) ka filluar në Dhjetorë të vitit 2004. Në korporatizim, si rezultat shoqëria aksionare apo shoqëritë do të regjistrohen në regjistrin e biznesit të Kosovës.

### **PËRMBLEDHJE E RREGULLOREVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

#### **a) Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas konventës historike të shpenzimeve, siç është modifikuar nga ri- vlerësimi i pronës së duhur, ndërtesave dhe pajisjeve.

Me përjashtim të shmangieve në vijim të Standardeve Ndërkombëtare Kontabël (SNF), këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me standardet dhe shpjegimet e aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare Kontabel (BSNF), të cilat referohen si Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto standarde dhe interpretime më parë ishin të emëruara si SNF.

- Asnjë provizion nuk është ngritur për pjesën e pa financuar të vlerës aktuale të pagesave të pritura për të sistemuar obligimet pensionale siç është kërkuar nga SNF Nr.19 në benefitet e punëtorëve.
- Nuk është marrë parasysh rezervimi i benefiteve tatimore për të ardhmen që rezultojnë në diferencat kohore siç kërkohet nga SNF Nr.12 në taksat mbi të ardhurat.
- Të ardhurat nga thirrjet për rrjetin mobil VALA-në 900 janë llogaritur si para të pranuar më tepër se sa në baza përlllogaritura siç kërkohet nga SNF Nr.1 në prezantimin e pasqyrave financiare.

**b) Monedha raportuese**

Monedha raportuese e PTK-së është njësia monetare e Unionit Evropian (EURO), e identifikuar si "EUR."

Transaksionet në monedha tjera përveç EUR në fillim janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit në datat e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare me vlera monetare të huaja janë kthyer me normën e tregut të këmbimit në datën e gjendjes së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin gjatë këmbimit janë regjistruar në pasqyrën e operimeve të periudhës në të cilën janë paraqitur.

**c) Përdorimi i parashikimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhshmëri me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëj parashikime dhe supozime të cilat ndikojnë vlerat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve, shpalosjet e aseteve kontingjente dhe detyrimeve në datën e pasqyrave financiare dhe vlerave të raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Këto parashikime bazohen në informatat në dispozicion si në datën e pasqyrave financiare dhe rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato parashikime.

**d) Prona, ndërtesat dhe pajisjet**

Prona, ndërtesat dhe pajisjet janë të cekura në shpenzime ose vlerësime pa amortizimin e akumuluar dhe provizionin për dëmin, ku kërkohet. Kur vlera bartëse e një asemi është më e madhe se vlera e rikuperueshme, është e shënuar në vlerën e tij të rikuperueshme dhe dallimi i ngarkohet pasqyrës së operimeve.

Shuma e rikuperueshme e e parashikuar është më e lartë se çmimi neto i shitjes së asetit dhe vlera e tij në përdorim.

Shpenzimet kapitale në asete gjatë ndërtimit barten drejt në Asetet në Ndërtim dhe janë të kapitalizuara dhe të transferuara në kategorinë e duhur të aseteve kur të kompletohen, prej kohës kur amortizimi aplikohet me normën e aplikueshme për kategorinë në fjalë.

Fitimet dhe humbjet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve përcaktohen duke u referuar në shumën bartëse të tyre dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultateve operative për periudhën. Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.

Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën e linjës së drejtë për kategoritë më të mëdha të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve duke përdorur parashikimet e kohëzgjatjes si në vijim:

Ndërtesat dhe lidhjet e rrjetit 20 vite

Makinerinë dhe pajisjet 5 vite.

Trualli nuk amortizohet ngase konsiderohet të ketë kohëzgjatje të pakufizuar.

#### **e) Asetet e patrupëzuara**

Asetet e patrupëzuara të siguruara nga PTK janë të cekura të shpenzimet pa amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga dëmi. Amortizimi është bërë në bazat të linjës së drejtë, i kalkuluar për shlyerjen e kostos së aseteve të patrupëzuara mbi kohëzgjatjen e tyre të parashikuar si në vijim:

Programet kompjuterike 5 vite

Licencat 15 vite

#### **f) Inventari**

Inventari është i regjistruar me koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto pas realizimit të lejimit të nevojshëm për artikujt e vjetruar apo që lëvizin ngadalë. Kostoja përcaktohet duke përdor koston mesatare të ngarkesës të bazës kontabël.

#### **g) Të arkëtueshmet**

Provizioni për borxhet e dyshimta është llogaritur sipas metodologjisë në vijim:

	<b>Provizioni %</b>
Mbi 12 muaj	100%
6 deri 12 muaj	75%
3 deri 6 muaj	50%
Më pak se 3 muaj	10%

#### **h) Njohja e të ardhurave operative**

Të ardhurat nga telefonia mobile nga kartelat parapaguese rimbushëse njihen në baza akruale për fund vitin 31 Dhjetor 2004. Të ardhurat nga ky burim njihen nga shitja e kartelave rimbushëse për fund vitin 31 Dhjetor 2003.

Të ardhurat e thirrjeve të telefonisë mobile regjistrohen të bazë të parave të gatshme.

Të ardhurat e lidhjes fikse njihen sipas faturimin mujor ndaj klientëve.

Të ardhurat e tjera operuese njihen kur ofrohen produktet dhe shërbimet.

#### **i) Njohja e interesit në të ardhura**

Interesi në të ardhura njihet në pasqyrën e operimeve për të gjitha instrumentet që bartin interes në baza akruale.



#### **j) Tatimi**

PTK-së i është kërkuar të paguaj tatim në profit tatimor për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me direktivat administrative të UNMIKUT të aplikueshme për periudhën e caktuar.

#### **k) Grantet në lidhje me asetet**

Grantet në lidhje me asetet, përfshijnë grantet jo-monetare në vlerë e tregut, janë të prezantuara në bilancin e gjendjes duke i bërë grantet si të ardhura të vonuara. Të ardhurat e vonuara njihen si të ardhura në baza racionale dhe sistematike gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të aseteve në lidhje me to.

#### **l) Paratë dhe ekuivalentët e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paratë konsiderohen të jenë para në dorë dhe në llogaritë operative në banka. Ekuivalentët e parasë përfaqësojnë depozitat e pa kufizuara me maturitete më të shkurtër se tre muaj.

#### **m) Përfitimet e punëtorëve**

PTK, në rrjedha normale të biznesit, bën pagesat në emër të punëtorëve të vet për pensione dhe tatime në të ardhura personale të cilat janë të kalkuluar në bazë të pagave bruto dhe pagat sipas legjislacionin lokal. Këto shpenzime u ngarkohen pasqyrave operative në të njëjtën periudhë si shpenzime lidhura me rrogat.

#### **n) Shumat krahasuese**

Shumat krahasuese për fund vitin 31 dhjetor 2003 janë rishikuar për të përfshirë korrigjimet e gabimeve të identifikuara lidhur me vitet 2002 dhe 2003. Ky rishqyrtim ndikon në pasqyrën financiare për fund vitet 31 dhjetor 2002 dhe 2003 siç është raportuar më parë dhe pasqyrohet në hapjen e fitimeve të mbajtura si me 1 janari 2003 dhe 2004, përkatësisht. Shumat e caktuara për vitin paraprak janë ri klasifikuar për tu përshtatur me bazat e paraqitjes së vitit aktual.

#### **o) Raportimi segmental**

PTK është në proces të krijimit të procedurës së raportimit nga sektori madhor i biznesit, duke përfshirë alokimet e shpenzimeve në segmentin ndër-biznesor.

## 3. PRONA, NDËRTESTAT DHE PAISJET

	Trualli dhe Ndërtesat ( EUR 000)	Lidhjet ( EUR 000)	Makineri dhe Pajisjet ( EUR 000)	Puna në progres ( EUR 000)	Totali ( EUR 000)
<b>Kostoja / vlerësimi</b>					
<b>Bilanci më 1 janar 2004 siç është raportuar më parë</b>	<b>25,938</b>	<b>15,145</b>	<b>62,854</b>	<b>8,031</b>	<b>111,968</b>
Shtesat e vitit paraprak	794	31	2,745	-	3,570
Transferet e vitit paraprak	17	225	4,007	(5,565)	(1,316)
<b>Bilanci me 1 janar 2004 si i rishqyrtuar</b>	<b>26,749</b>	<b>15,401</b>	<b>69,606</b>	<b>2,466</b>	<b>114,222</b>
Shtesat	136	3,204	1,715	5,712	10,767
Transferet	-	-	-	(3,792)	(3,792)
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>26,885</b>	<b>18,605</b>	<b>71,321</b>	<b>4,386</b>	<b>121,197</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>					
<b>Bilanci më 1 janar 2004 siç është raportuar më parë</b>	<b>9,282</b>	<b>8,898</b>	<b>38,633</b>	<b>-</b>	<b>56,813</b>
Kthimi i zhvlerësimit për 2003	-	(2,578)	(9,123)	-	(11,701)
Ngarkimi shtesë në lidhje me vitet e kaluara	88	26	2,701	-	2,815
<b>Bilanci më 1 janar 2004 si i rishqyrtuar</b>	<b>9,370</b>	<b>6,346</b>	<b>32,211</b>	<b>-</b>	<b>47,927</b>
Ngarkimi për vitin	1,075	872	14,051	-	15,998
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>10,445</b>	<b>7,218</b>	<b>46,262</b>	<b>-</b>	<b>63,925</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>					
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>16,440</b>	<b>11,387</b>	<b>25,059</b>	<b>4,386</b>	<b>57,272</b>
Bilanci më 31 dhjetor 2003 siç është raportuar më parë	16,656	6,247	24,221	8,031	55,155
Bilanci me 31 dhjetor 2003 i rishqyrtuar	17,379	9,055	37,395	2,466	66,295

Në mënyrë efektive që nga 1 janari 2002 prona, ndërtesat dhe pajisjet janë rivlerësuar nga PTK duke përdorur burimet e brendshme. Përshtatjet që rezultojnë nga rivlerësimi kanë zvogëluar vlerën neto kontabël të Lidhjeve dhe Makinerisë & Pajisjeve si me 1 janar 2002 nga shuma totale prej 53 milion Euro. Përderisa këto përshtatje nuk mund të alokohen si duhet brenda kategorive individuale të asetëve, ngarkimi i zhvlerësimeve për vitin 2003 është nxjerrë automatikisht në sistemin kontabël duke mos marrë parasysh koston e rivlerësuar të Lidhjeve, Makinerisë dhe Pajisjeve. Prandaj, gjendja e zhvlerësimeve të akumuluar më 1 janar 2004, është rishqyrtuar për të përmirësuar shumën e ngarkimit zhvlerësues të realizuar në vitin 2003 (shih Shënimin 10). Për më tepër, shumat e caktuara të përfshira në bilanci e punës në

Zhvillim dhe paradhëniet në llogaritë e furnizuesve më 31 dhjetor 2003, janë kapitalizuar në mënyrë retroaktive në vitin 2004. Kosto të ngjashme janë të paraqitura me shumat e shtesave dhe transferove të vitit paraprak (shih Shënimin 10).

Çështjet e pronësisë ekzistojnë lidhur me infrastrukturën e trashëguar me fillimin e administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Kjo përfaqëson kontingjentin potencial të detyrimeve të PTK-së e cila nuk është kuantifikueshme për momentin.

Si pjesë e procesit të korporatizimit PTK-ja është në proces të rivlerësimit të të gjitha aseteve fikse dhe të alokimit të tyre në segmente të ndryshme të biznesit.

<b>4. ASETET E PA TRUPËZUARA</b>	<b>Programet kompjuterike ( EUR 000)</b>	<b>Licencat ( EUR 000)</b>	<b>Totali ( EUR 000)</b>
<b><u>Kostoja / vlerësimi</u></b>			
<b>Bilanci më 1 janar 2004</b>			
<b>Siç është raportuar më parë</b>	764	-	764
Shtesat e vitit paraprak	7,536	-	7,536
Transferet e vitit paraprak	1,316	-	1,316
<b>Bilanci me 1 janar 2004 si i rishqyrtuar</b>	<b>9,616</b>	<b>-</b>	<b>9,616</b>
Shtesat	116	9,400	9,516
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>9,732</b>	<b>9,400</b>	<b>19,132</b>

#### **Zhvlerësimet e akumuluar**

##### **Gjendja më 1 janar 2004**

##### **siç është raportuar më parë**

Ngarkimi shtesë në lidhje me vitet e kaluara	1,548	-	1,548
--	-------	---	-------

##### **Bilanci më 1 janar 2004**

<b>si i rishqyrtuar</b>	<b>1,574</b>	<b>-</b>	<b>1,574</b>
-------------------------	--------------	----------	--------------

Ngarkimi për vitin	1,941	261	2,202
--------------------	-------	-----	-------

<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>3,515</b>	<b>261</b>	<b>3,776</b>
-----------------------------------	--------------	------------	--------------

#### **Vlera Neto Kontabël**

<b>Bilanci më 31 dhjetor 2004</b>	<b>6,217</b>	<b>9,139</b>	<b>15,356</b>
-----------------------------------	--------------	--------------	---------------

Bilanci më 31 dhjetor 2003			
----------------------------	--	--	--

siç është raportuar më parë	738	-	738
-----------------------------	-----	---	-----

Bilanci më 31 dhjetor 2003			
----------------------------	--	--	--

si i rishqyrtuar	8,042	-	8,042
------------------	-------	---	-------

Programi kompjuterik lidhet me koston e sistemit të faturimit dhe ISP-në. Shpenzimet e trajnimeve në lidhje me këtë janë kapitalizuar përbrenda këtyre aseteve.

Në korrik 2004 janë bërë dy licencime për 15 vite për të operuar me telekomunikimin përbrenda Kosovës, e konsistuar nga licenca mobile prej 6.5 milion Euro dhe licenca fikse prej 2.9 milion Euro.

Shtesat e punës në zhvillim për vitin paraprak dhe paradhëniet për furnizuesit janë kapitalizuar në mënyrë retroaktive në vitin 2004.

Ngarkimi i amortizimit në lidhje me vitet paraprake, përfaqëson ngarkimin për vitin 2003 në lidhje me asetet e kapitalizuara në mënyrë retroaktive siç është përshkruar më sipër.

<b>5. INVENTARI</b>	<b>31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Kabllo dhe materialet mirëmbajtëse	2,046	1,194
SIM kartelat dhe kartelat rimbushëse	390	376
Artikujt postar	123	93
Inventar të tjerë	347	424
	<b>2,906</b>	<b>2,087</b>
<b>6. LLOGARITË E ARKËTUESHME</b>	<b>31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Konsumatorët e linjave fikse personat fizik	21,473	21,179
Konsumatorët e linjave fikse personat juridik	17,608	14,531
Të arkëtueshme e dyshimta konsumatorët e linjave fikse	3,541	3,285
Konsumatorët postpaid të rrjetit mobil Vala 900	3,413	3,049
Të arkëtueshme roming Monaco Telecom	2,209	2,448
Të arkëtueshme nga telefonatat hyrëse Monaco Telecom	11,560	22,882
Shërbimet postare	439	288
Konsumatorët e shërbimeve të internetit	259	173
Llogaritë e tjera të arkëtueshme	560	588
	61,062	68,423
Provizionet për borxhet e dyshimta	(41,010)	(35,836)
	<b>20,052</b>	<b>32,587</b>

Të hyrat nga thirrjet e telefonisë mobile janë të regjistruara në bazë të parasë së gatshme sipas raporteve financiare periodike të dhëna nga furnizuesi e tij për shërbimet e rrjetit, Monaco Telecom. Këto të hyra po të ishin pranuar në baza akruale, të farkëtueshmet e thirrjeve hyrëse do të ishin rritur për 12,065 mijë Euro me 31 dhjetor 2004 (11,764 mijë Euro me 31 dhjetor 2003).

Lëvizshmëria në provizion për borxhet e dyshimta është përmbledhur me sa vijon:

	<b>31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
<b>Bilanci i hapur më 1 janar</b>	35,836	29,096
Rritje lidhur me konsumatorët e linjave fikse	5,174	6,740
<b>Mbyllja e bilancit me 31 dhjetor</b>	<b>41,010</b>	<b>35,836</b>

Shënime për Raportet Financiare

<b>7. TË ARKËTUESHME TJERA</b>	<b>31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Paradhëniet për furnizuesit	332	649
Të arkëtueshmet nga punëtorët	63	96
Shpenzimet parapaguese	1,073	816
Interesi I depozitave të përlllogaritura bankare	2,100	655
Llogaritë e tjera të arkëtueshme	951	144
	<b>4,519</b>	<b>2,360</b>

Barazimi i krahasimeve të rishikuara për të arkëtueshmet tjera:

**31 dhjetor  
2003  
( EUR 000)**

<b>Të arkëtueshmet tjera si janë raportuar me parë</b>	<b>11,975</b>
<b>Përshtatjet:</b>	
Kapitalizimi i paradhënieve për furnizuesit, për pronë, ndërtesa dhe pajisje (Shënimi 3)	(3,570)
Kapitalizimi i paradhënieve për furnizuesit, për asetet e patrupëzuara (Shënimi 3)	(7,535)
Paradhëniet për furnizuesit të ri klasifikuar për llogaritë e pagueshme (Shënimi 11)	(28)
Interesi i depozitave të përlllogaritura bankare (Shënimi 10)	655
<b>Ri klasifikimet:</b>	
Shpenzimet parapagueshme	816
Llogaritë tjera të farkëtueshme	47
<b>Të arkëtueshmet tjera të rishikuar</b>	<b>2,360</b>

<b>8. PARATË E GATSHME DHE BILANCET BANKARE</b>	<b>31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Llogaritë aktuale me bankat lokale	4,487	62,365
Llogaritë aktuale me bankat e jashtë vendit	-	124
Paraja në dorë	332	102
<b>Llogaritë aktuale dhe paraja në dorë</b>	<b>4,819</b>	<b>62,591</b>
Investimet afatshkurta	152,591	33,817
<b>Paratë e gatshme dhe bilancet bankare</b>	<b>157,410</b>	<b>96,408</b>

Investimet afatshkurta me 31 dhjetor 2004 paraqesin depozitat e bankës të mbajtura në shtatë bankat lokale në Kosovë (2003 pesë banka lokale). Depozitat maturojnë brenda periudhave që radhiten prej një muaji deri në dymbëdhjetë muaj nga data e gjendjes së bilancit. Gjatë vitit është fituar interes në këto llogaritë të depozitave në normën që ndryshon në mes 1.9% dhe 4.55% (2003 2.6% dhe 4%).



**9. LLOGARIA KAPITALE**

Llogaria kapitale është rezervuar me 1 janar 2000, bazuar në vlerën neto kontabël të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve, linjave, inventarit dhe parasë se gatshme të identifikuar me fillimin e veprimit të PTK-së në gusht të vitit 1999. Kjo shumë kapitale duhet të regjistrohet formalisht me autoritetet relevante në Kosovë.

<b>10. FITIMET E MBAJTURA</b>	<b>2004</b>	<b>2003</b>
	<b>( EUR 000)</b>	<b>( EUR 000)</b>
<b>Hapja e Fitimeve të Mbajtura siç janë raportuar më parë</b>	<b>149,480</b>	<b>121,505</b>
Përshtatjet me vitin paraprak (shih tabelën e mëposhtme)	9,837	(1,475)
<b>Hapja e Fitimeve të Mbajtura siç janë rishqyrtuar</b>	<b>159,317</b>	<b>120,030</b>
Fitimi për vitin	47,778	29,450
<b>Mbyllja e Fitimeve të Mbajtura</b>	<b>207,095</b>	<b>149,480</b>

**Përshtatjet e vitit paraprak që ndikojnë në Fitimet e Mbajtura**

	<b>2004</b>	<b>2003</b>
	<b>( EUR 000)</b>	<b>( EUR 000)</b>
Të hyrat nga interesi i depozitave afatshkurta të paregjistruara në 2003	655	-
Ndikimi i tatimit për arsye të të hyrave të paregjistruara të interesit në 2003	(131)	-
Kthimi i ngarkimit të zhvlerësimit për 2003 në lidhje me rivlerësimin e Linjave, Makinerisë dhe Pajisjeve	11,701	-
Ndikimi i tatimit për kthimin e ngarkimit të zhvlerësimit në 2003	(287)	-
Ngarkimi shtesë i zhvlerësimit që kanë të bëjnë me asetet fikse dhe të patrupëzuara të kapitalizuara në 2002	-	(1,735)
Ndikimi i tatimit në asetet fikse dhe të pa trupëzuara të kapitalizuara në 2002	-	260
Ngarkimi shtesë i zhvlerësimit që kanë të bëjnë me Linjat, Makinerinë dhe Pajisjet të kapitalizuara në 2003	(1,695)	-
Ngarkimi shtesë i amortizimit që kanë të bëjnë me asetet e patrupëzuara të kapitalizuara në 2003	(932)	-
Ndikimi i tatimit në asetet fikse dhe të patrupëzuara të kapitalizuara në 2003	526	-
	<b>9,837</b>	<b>(1,475)</b>

<b>11. LLOGARITË E PAGUESHME</b>	<b>31 dhjetor 2004 (EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 (EUR 000)</b>
Monako Telecom, Monako	2,597	2,461
Auto Visoka, Kosovë	399	-
Llogaritë e tjera të pagueshme	766	1,008
	<b>3,762</b>	<b>3,469</b>

Llogaritë e pagueshme me 31 dhjetor 2003 janë rishqyrtuar me një zbritje prej 28 mijë Euro si rezultat i shlyerjes së paradhënieve ndaj bilanceve të furnizuesve të bëra në 2004 (Shënimi 7).

<b>12. LLOGARITË E TJERA TË PAGUESHME</b>	<b>31 dhjetor 2004 (EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 (EUR 000)</b>
Tatimi i pagueshëm i fitimit të Korporatës (Shënimi 19)	4,308	4,128
Kontributet pensionale të pagueshme	862	861
Paradhëniet e pranuar	696	555
T.V.SH e paguar	694	1,065
Pagat e paguara	568	724
Tatimet e pagueshme në paga	197	175
Të pagueshmet tjera	427	189
	<b>7,752</b>	<b>7,697</b>

<b>13. TË HYRAT E SHTYRA</b>	<b>31 dhjetor 2004 (EUR 000)</b>	<b>31 dhjetor 2003 (EUR 000)</b>
Kartelat parapaguese rimbushëse	1,756	-
Asetet e donuara	308	454
	<b>2,064</b>	<b>454</b>

Të hyrat e shtyra në lidhje me kartelat parapaguese, kanë të bëjnë me pjesën e papërdorur të kartelave që u janë shitur konsumatorëve gjatë vitit. Asnjë zbritje e ardhshme nuk është bërë lidhur me 31 dhjetor 2003.

Të hyrat e shtyra në lidhje me donacionet paraqesin asetet e donuara nga entitetet e ndryshme duke përfshirë UNMIK-un dhe Agjencionin Evropian për Rindërtim (EAR), për PTK-ne gjatë vitit 2000.

## Shënime për Raportet Financiare

Të hyrat e shtyra lidhur me asetet e donuara hiqen nga të ardhurat sig është detajuar më poshtë:

	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
<b>Hapja e bilancit me 1 janar</b>	<b>454</b>	<b>637</b>
Heqja nga të ardhurat tjera jo-operative	(146)	(183)
<b>Mbyllja e bilancit me 31 dhjetor</b>	<b>308</b>	<b>454</b>

<b>14. TË ARDHURAT OPERATIVE</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Të ardhurat nga shërbimet e telefonisë mobile	86,812	75,013
Të ardhurat nga linjat fikse	31,562	32,948
Të hyrat nga kabinat telefonike	7,533	8,979
Të ardhurat postare	1,281	954
Të ardhurat nga shërbimet e internetit	590	788
Të ardhurat e tjera	705	120
	<b>128,483</b>	<b>118,802</b>

Të ardhurat nga parapaguesit e telefonisë mobile njihen me shitjen e kartelave rimbushëse për fund vitin 31 dhjetor 2003. Nëse kjo rregullore kontabël do të aplikohet për fund vitin 31 dhjetor 2004, fitimi i PTK-së për këtë fund vit do të ishte rritur për 1.756 mijë Euro më debitë korresponduese të bëra për llogarinë e të hyrave të shtyra.

<b>15. KOSTOT OPERATIVE</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Shpenzimet e komisionit në lidhje me të ardhurat e parapagimit	9,562	11,174
Shpenzimet e komisionit në lidhje me të ardhurat e romingut	1,988	2,630
Shpenzimet e komisionit në lidhje me të ardhurat e postpaid-it	1,395	1,334
Kostot e karburantit	1,329	1,138
Kostot e rrjetit të telefonisë mobile	793	838
Shërbimet publike	794	667
Lidhja satelitore dhe pajisjet	499	601
Kostot e tjera operative	1,675	2,179
	<b>18,035</b>	<b>20,561</b>

Shënime për Raportet Financiare

<b>16. KOSTOT E PERSONELIT</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Pagat	11,739	10,018
Pensionet e paguara drejtpërdrejt punëtorëve të pensionuar	622	162
Kostot pensionaleskema e gjendjes	1,605	1,388
Kostot pensionaleskema plotësuese (shih shënimin 23)	1,601	1,372
Shujtat e ushqimeve	2,887	2,818
Kostot e tjera të personelit	590	356
	<b>19,044</b>	<b>16,114</b>

Me 31 dhjetor 2004 PTK-ja ka punësuar 2.208 punëtor (31 Dhjetor 2003 - 2,190 punëtor).

<b>17. KOSTOT E TJERA OPERATIVE</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Shpenzime të zyrës dhe administratës	2,799	2,844
Obligimet doganore dhe tatimet	2,790	1,705
Sigurimi dhe mirëmbajtja	1,307	1,683
Qiraja	949	953
Marketingu	737	202
Gjoba dhe ndëshkimet	316	327
Ngarkimet dhe shërbimet bankare	96	140
Provizioni dhe borxhet e dyshimta (shih Shënimin 6)	5,174	6,740
	<b>14,168</b>	<b>14,594</b>

**18. TË HYRAT FINANCIARE**

Kjo llogari prezanton interesin e të hyrave të fituara nga bilancet i llogarive të depozitave afatshkurta të mbajtura në bankat vendore gjatë vitit, siç shpjegohet në Shënimin 8.

	<b>Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)</b>	<b>Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)</b>
Të hyrat financiare	3,854	1,138
	<b>3,854</b>	<b>1,138</b>

Shuma krahasuese e raportuar si më parë është rishqyrtuar me shumën prej 655 mijë Euro në lidhje me të hyrat e interesit për vitin 2003 e cila është rezervuar në 2004 në saj të vendosjes së sistemit të bazuar në para të gatshme gjatë vitit 2003.

Shënime për Raportet Financiare

19. TATIMI

	Fund viti 31 dhjetor 2004 ( EUR 000)	Fund viti 31 dhjetor 2003 ( EUR 000)
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>63,119</b>	<b>52,090</b>
<b>Add back: Të ardhurat dhe shpenzimet e panjohura</b>		
Amortizimi	6,687	3,625
Tatimet e pagave	-	1,233
Provizioni për borxhet e dyshimta	5,176	6,740
Gjorbitjet dhe ndëshkimet	316	327
Shpenzimet e shtyera parapaguese	(337)	-
Të hyrat e shtyera parapaguese, neto prej komisioneve	1,744	-
<b>Fitimi i tatueshëm për vitin</b>	<b>76,705</b>	<b>64,015</b>

**Shpenzimi i tatimit në fitim në normën prej 20%** **15,341** **12,803**

Shuma krahasuese e ngarkimit të zhvlerësimit që nuk është e lejuar për qëllime të taksës është rishqyrtuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2004 ( EUR 000)	31 dhjetor 2003 (e rishqyrtuar) ( EUR 000)	31 dhjetor 2003 siç është raportuar më parë ( EUR 000)
Ngarkimi i zhvlerësimit në baza të linjës së drejtë	15,998	25,835	25,835
Rregullimi i ri vlerësues (shënimi 10)	-	(11,701)	-
Ngarkimi i zhvlerësimit në baza të zvogëlimit të bilancit	( 9,311)	(10,509)	(11,943)
<b>Ngarkimi i zhvlerësimit të panjohur për qëllime të taksave</b>	<b>6,687</b>	<b>3,625</b>	<b>13,892</b>

Harmonizimi i taksës së korporatës të pagueshme në datën e bilancit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2004 ( EUR 000)	31 dhjetor 2003 ( EUR 000)
Tatimi në fitim i korporatës i pagueshëm si më 1 janar	4,128	4,853
Shpenzimi i tatimit në fitim (shih llogaritjen më lartë)	15,341	12,803
Pagesat e bëra të tatimit në fitim gjatë vitit	(15,161)	(13,528)
<b>Tatimi në fitim i korporatës i pagueshëm si më 31 dhjetor (shënimi 12)</b>	<b>4,308</b>	<b>4,128</b>

Shumat krahasuese janë rishqyrtuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2003 ( EUR 000)
<b>Tatimi në fitim i korporatës i pagueshëm siç është raportuar më parë</b>	<b>4,496</b>
Tatimet e pagueshme që kanë të bëjnë me 2002 (shënimi 10)	(260)
Tatimet e pagueshme që kanë të bëjnë me 2003 (shënimi 10)	(108)
<b>Tatimi në fitim i korporatës i pagueshëm dhe i rishqyrtuar</b>	<b>4,128</b>

Beneficioni nga tatimi në të ardhmen nuk është regjistruar për të marrë parasysh të gjitha ndryshimet e përkohshme që rrjedhin në mes të bazave të tatimit kontabël për asetet dhe detyrimet dhe shumat bartëse për qëllime të raportimit financiar.



## 20. RIPASQYRIMET KRAHASUESE

Një përmbledhje e rregullimeve dhe ri klasifikimeve në lidhje me asetet, detyrimet, të ardhurat dhe llogaritë e kostos që janë rishikuar me 1 janar 2003 dhe 2004 është si në vijim:

	31 dhjetor 2003 të raportuara si më parë Shënim (EUR 000)	Paradhë- niet ndaj furnizues sve të Rivlerësimi kapitalz i zhvlerë uara (EUR 000)	Zhvlërësimi i aseteve të kapital- izuara në mënyrë retroaktive (EUR 000)	Të hyrat e interesit të pa regjistruara (EUR 000)	Shpenzime të tatimit në tatim (EUR 000)	31 Rregullimet dhjetor e ri pasqyr- 2003 si imeve totale rishikuar në 2003 (EUR 000)	Rregullimet e ri pasqyr- imeve totale në 2002 (EUR 000)
<b>Llogaritë e bilancit</b>							
Prona, ndërtesat dhe pajisjet	3	55,155	2,254	11,701	(2,815)	66,295	11,140
Asetet e patrupëzuara	4	738	8,852	-	(1,548)	8,042	7,304
Paradhëniet ndaj furnizuesve	7	11,782	(11,133)	-	-	649	(11,133)
Interesi i deponitave akruale bankare	7	-	-	-	-	655	655
Llogaritë e pagueshme	11	(3,497)	28	-	-	(3,469)	28
Tatimi në fitim i korporatës i pagueshëm	21	(4,496)	-	-	368	(4,128)	368
<b>Ndikimi total në Bilanc</b>						<b>8,362</b>	
<b>Llogaritë e pasqyrës së operimeve</b>							
Fitimet e mbajtura	10	-	-	-	260	(1,475)	-
Zhvlërësimi		(25,834)	-	11,701	(1,735)	15,828	10,006
Amortizimi		(26)	-	-	(1,695)	958	(932)
Të hyrat financiare	20	483	-	-	655	(1,138)	655
Shpenzimi i tatimit në fitim taksave tatataksave	21	(12,911)	-	(287)	(131)	12,803	108
<b>Ndikimi total në Pasqyrën e Operimeve operative</b>						<b>9,837</b>	<b>(1,475)</b>
<b>Fitimi i vitit 2003</b>							
Fitimi bruto	21	42,361	-	11,701	(2,627)	52,090	9,729
Fitimi neto		29,450	-	11,701	(2,627)	39,287	9,837

## 21. PALËT E NDËRLIDHURA

Në kursin e zakonshëm të biznesit, PTK-ja ka hyrë në transaksione gjatë periudhës raportuese financiare me klientët të cilët janë etnitet të UNMIK-ut dhe individ që janë të shoqëruar me ose punojnë për etnitetin e UNMIK-ut. Të gjitha këto transaksione janë kryer në baza mbizotëruese. Shumat totale monetare të transaksioneve të tilla dhe bilanceve në lidhje me to të cilat janë përfshirë në këto pasqyrat financiare, nuk janë kuantifikuar.

## 22. ZOTIMET KAPITALE

Më 31 dhjetor 2004 zotimet kapitale të PTK-së kapën shumën prej 6 milion Euro.

Shpenzimet kapitale të autorizuara por jo të zotuar në këtë datë janë llogaritur në 70 milion Euro, prej të cilave 47 milion Euro janë tenderuar dhe 23 milion Euro janë në procesin e para tenderimit.

## 23. SKEMA E PENSIONEVE PLOTËSUESE

Nga 1 janari i vitit 2003, është formuar një skemë për pensionet plotësuese për të gjithë të punësuarit, duke bërë pagesën e 10% të pagave bruto në Autoritetin bankar të pagesave të Kosovës (BPK). Kjo skemë e pensioneve është plotësuese dhe si e tillë është e veçuar nga Fondi shtetëror i pensioneve.

Shpenzimet e pensioneve plotësuese kanë shumën 1.601 mijë € për vitin 2004, (1.372 mijë € për vitin 2003).

Asnjë ngritje e provizionit nuk është bërë në këto pasqyra financiare për vlerën e tashme të supozuar nga pagesa e faturave që nevojiten për zgjidhjen e obligimeve që rrjedhin nga drejta e pensioneve për shërbimet e kaluara të PTK-së të të punësuarve që tani janë pensionuar, ose që do të pensionohen nga PTK-ja para se të arrijnë të drejtën e pensionit nga Trusti Pensional i Kosovës për ata të moshës 65 vjeçare.

Asnjë vlerësim aktual që ka të bëjë me këtë borxh nuk është përmbushur që të përcaktoj nëse fondet e pensioneve të përcaktuara me datë 31 dhjetor 2004 që mbajnë shumën prej 2.8 milion € janë adekuate të mbulojnë këto borxhe.

## 24. MASAT JURIDIKE

PTK-ja është nënshtruar ndaj masave juridike, kërkesave dhe ngritjes së çështjeve gjyqësore bazuar në rrjedha të zakonshme të biznesit. Menaxhmenti beson se çmimi final për të zgjedhur këto çështje nuk do të ketë efekt negativ material që do të ndikonte në pozitën financiare të PTK-së, rezultatet e operimeve, ose në rrjedhje të parasë.

## 25. VLERAT E TREGUT DHE RISKU I MENAXHMENTIT

Vlera e tregut është përcaktuar si shumë për të cilën një aset mund të këmbehet, ose një detyrim të shlyhet, në mes të palëve mirë të informuara dhe që janë të gatshëm për transaksione afatgjate. Libri kontabël i aseteve financiare dhe detyrimeve të PTK-së është i përafërt me vlerën e tyre të tregut si datat e bilancit të gjendjes.

### Rreziku i kreditit

Asetet financiare të cilat potencialisht e nënshtrojnë PTK-në drejt përqendrimit të riskut të kredisë që janë të përbëra kryesisht prej parave dhe ekuivalentëve të parasë dhe llogaritë e arkëtueshmet. Llogaritë bankare të PTK-së janë të sistemuara në institucione financiare lokale e që janë meritore për vlerësimin e kredive ndërsa llogaritë e arkëtueshme janë prezantuar neto nga provizioni i duhur për dëmtim në vlerë.

### Rreziku i normës së interesit

Llogaritë e depozitimeve të PTK-së fitojnë interes në përqindje komerciale dhe afatizime.

### Rreziku i këmbimit të jashtëm

PTK-ja nuk ka ndonjë rrezik në ekspozim domethënës te këmbimeve të huaja qysh prej atëherë kur të gjitha transaksionet kanë kaluar në Euro.

### Rreziku i likuiditetit

PTK-ja monitorin likuiditetin në baza të rregullta me qëllim që të menaxhoj obligimet e saj kur ato duhet te kryhen.

## Të Arriturat Financiare

Në vitin 2004, pasqyra financiare e PTK-së është përmirësuar me një rritje të aseteve të përgjithshme për €49.7 milionë në krahasim me vitin 2000. Kjo arritje është mbizotëruar me rritjen e parave të gatshme prej €61.2 milionë euro. Të hyrat janë përmirësuar prej €9.7 milionë të cilat kanë rezultuar me rritje në fitim para taksës me €11.0 milionë.

Rritja në rezervat e parave të gatshme kryesisht është shkaktuar nga paaftësia e PTK-së për të implementuar projekte vendimtare dhe të rëndësishme nën regjimin e tanishëm të prokurimit. Projektet kapitale janë të nevojshme për t'i përmbushur obligimet e shërbimit, të përmirësojë rritjen e numrit të konsumatorëve dhe shërbimeve, ndërsa modernizimi i sistemit të shpërndarjes është i gatshëm për konkurrencën e afërt.

Një përmirësim mjaft i rëndësishëm në vitin 2004 është ndryshimi i metodologjisë së llogaritjes nga baza e parave të gatshme në baza akruale duke adoptuar kështu Standardet ndërkombëtare të llogaritjes (International Accounting Standards ( IAS )). Raportet mujore gjithnjë janë paraqitur për informimin e menaxhmentit, kështu që këto procedura të ndërprera duhet të përmirësohen. Përderisa ekziston ende një vend për përmirësim ( sikur që është theksuar nga kontrata e MTI-së për trajtimin e të hyrave ) një nivel i rëndësishëm i përmirësimit në raportim është arritur gjatë këtij viti, në mënyrë të posaçme në lidhje me ndarjen llogaritëse të fitimit dhe pasqyrën e humbjeve për katër njësitë e biznesit; kërkesa për licencim e lejuar gjatë vitit për telefoninë fikse dhe atë mobile, si edhe për ligjet e Postës dhe Telekomunikacionit.

Libri i vlerësimeve dhe ekzistenca e aseteve të palëvizshme kanë mbetur të paqarta në vitin 2004. Në mënyrë që të përgatitet një regjistër i saktë për rivlerësimin e aseteve janë autorizuar disa konsulent të cilët po menaxhojnë me procesin e korporatizimit, i cili ka filluar që nga dhjetori 2004. Përfundimi i këtij procesi do të mundësojë ndarjen llogaritëse të pasqyrës financiare për secilën prej katër njësive të biznesit.

Si pjesë integrale për rregullimin e regjistrimeve të PTK-së, një numër i projekteve puna e të cilave vazhdon në progres dhe të përkrahura nga vite të mëhershme kanë qenë të kapitalizuara, duke rezultuar me një riformulim të rezultateve në pasqyrën financiare të vitit 2003, të cilat revizionohen për herë të tretë nga Deloitte & Touche.